

Raport i ndermjetem monitorimi per subjektin politik LSI
date 13.06.2017

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR3986/PROT
DATE 13.06.2017

Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Tirane.

Raport i ndermjetem monitorimi date 13.06.2017

Ne ekspertet financiar Gezim Jaupaj dhe Anida Nuri me vendim nr. 374 date 09.06.2017 jemi emeruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve per te kryer monitorimin e fushates zgjedhore te subjektit politik LSI , duke perfshire aktivitetet , veprimtarine dhe materialet e perdorura gjate zhvillimit te fushates zgjedhore.

Ne kemi kryer monitorim me zgjedhje ne terren ne rruget e qyteteve dhe rruget nacionale, ne zyrat elektorale e ne ambiente ku partia ka zhvilluar aktivite elektorale. Me poshte po rendisim problematikat qe na pengojne ne zbatimin e detyres per respektimin e ligjeve dhe udhezimeve qe rregullojne organizimin e fushates zgjedhore nga partite politike.

1. Eshte e veshtire te takosh ndonje perfaqesues te Partise Politike per te marre informacion dhe dokumentacion per kryerjen e detyres.
2. Deri ditën e sotme subjekti zgjedhor nuk na ka dorezuar listen e aktiviteve te planifikuara per tu zhvilluar.
3. Deri ditën e sotme subjekti zgjedhor nuk na ka dorezuar listen e zyrave elektorale me te dhenat perkatese per venndodhjen, siperfaqen, pronari, lloji i marrveshjes per pagese, vlera e references se qirase etj.
4. Ne shume raste ne zyrat elektorale te monitoruara militantet e pranishem nuk te lejojne te hysh , te besh matje, te besh foto apo te marresh informacion.

Nga monitorimi ne terren i zyrave elektorale te subjektit politik ne disa raste jane konstatuar shkelje te ligjit nr.10019 date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" , ligjit nr. 8580 date 17.12.200 "Per partite politike" i ndryshuar me ligjin 90/2017 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580 date 17.12.200 "Per partite politike si dhe udhezimit te KQZ nr. 1 date 31.05.2017 "Per perdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore" dhe konkretisht:

1. Ne qender te qytetit te Durresit, fillimi rruges " Kasem Durresi" zyre elektorale e Lsi dhe perballe zyres eshte vendosur banderol qe tejkalon distancen 5 m nga zyra elektorale.
2. Rruga per Spitall prane maternitetit Durres Lagja nr.8 zyra elektorale e Lsi dhe banderol qe tejkalon distancen 5 m nga zyra elektorale.
3. Ne spitalle lagja 15 porto romano vendosur banderole ne distance me shume se 10m larg zyres elektorale.
4. Lagja nr 18 prane klinikes italiane San Giovanni dhe karburant "Përnoca" ndodhet zyre elektorale e subjektit politik dhe nje banderole qe tejkalon distancen 5 m nga zyra elektorale.
5. Kater rruget e shijakut, flamuj dhe banderola te subjektit politik te vendosura perballe zyres elektorale ne anen tjeter te kryqezimit ne me shume se 25 m distance.

Gezim JAUPAJ

Anida NURI



Raport i ndermjetem monitorimi per subjektin politik LSI
date 13.06.2017

6. Qender Manez ne Durres ne nje godine ne ndertim jane vendosur postera elektoral dhe flamuj te subjektit politik , ndersa zyra elektorale eshte 1 km me larg.
7. Lagje Sallmone shijak Durres (afer kompleksit Gjoka) flamuj te vendosur ne lokale dhe godina anes rruges automobilistike.
8. Nuk eshte respektuar udhezimi i KQZ nr. 1 date 31.05.2017 "Per perdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore" per numrin e zyrave elektorale ne nje lagje. Rruga muzeu Durres – Spital- porto romane eshte e mbushur me zyra elektorale pa respektuar rregullin nje lagje nje zyre. Ne Rrashbull dy zyra elektorale, ne Marikaj qarku Tirane dy zyra elektorale, ne Manez qarku Durres dy zyra elektorale.
9. Flamur i Lsi ne hyrje te shkolles Asim Zeneli ne Gjirokaster.
10. Ne fshatin "Asim Zeneli " ne Gjirokaster ne ndertesen ku jane ambientet e Parkut Arkeologjik te Antigonese ishte vendosur zyre elektorale e LSI , por pasi u publikua ne media zyra u hoq.

Gezim JAUPAJ



Anida NURI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ANIDA NURI
TIRANË
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR *